

VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 30 gusht 2013

Numri i lëndës: 2012-17

E

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 dhe 30 gusht 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me veprimin e përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 23 tetor 2012.

II. FAKTET

2. Më 10 shkurt 2012, një prokuror i EULEX-it ka nisur hetimin ndaj ankuesit për një vepër të dyshuar penale të pranimit të ryshfetit dhe ndaj dy të dyshuarve të tjerë për dyshimet për ryshfet. Më 27 mars 2012, hetimi ishte zgjeruar ndaj ankuesit në përfshirjen e një akuzë për keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe ndaj dy të dyshuarve të tjerë për ushtrim të ndikimit ndaj dy të dyshuarve të tjerë.
3. Më 27 mars 2012, gjykatësi i procedurës paraprake ka lëshuar një urdhër arresti ndaj ankuesit dhe dy të dyshuarve.
4. Më 2 prill 2012 ankuesi ishte arrestuar.
5. Në të njëjtën ditë, prokurori i ka kërkuar Gjykatës së Qarkut në Pejë të lëshoj urdhrin për paraburgim. Prokurori ka argumentuar se ka pasur dyshim të fortë se ankuesi kishte kryer vepra të rënda penale dhe se ka pasur mundësi që ai të përpiqej të arratisë ose të ndërhyjë në rrjedhën e drejtësisë.
6. Më 3 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë ka urdhëruar që ankuesi të paraburgosej për një muaj. Gjykata ka konsideruar se ka pasur dyshim të fortë se ankuesi mund të ketë kryer veprat penale për të cilat dyshohej. Për më tepër, Gjykata ka konstatuar se duke marrë parasysh pozitën profesionale, kontaktet dhe njohuritë në shkathtësitë hetimore të ankuesit, ka pasur mundësi të madhe që ai të përpiqej të manipulonte dëshmitë, të ndikonte në palën e dëmtuar apo në dëshmitarët.
7. Më 2 maj 2012, paraburgimi ndaj ankuesit ishte shtyrë për tre muaj, deri më 2 gusht 2012.
8. Më 31 korrik 2012, prokurori ka ngritur një aktakuzë ndaj ankuesit dhe të dy të dyshuarve të tjerë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
9. Më 2 gusht 2012, Gjykata e Qarkut ka shtyrë paraburgimin deri më 2 tetor 2012.
10. Gjatë seancës konfirmuese të akuzave më 4 shtator 2012, të pandehurit kanë kërkuar nga gjykatësi konfirmues të shqyrtoj ligjshmërinë e paraburgimit të tyre. Më 11 shtator 2012, gjykata ka gjetur se paraburgimi i tyre i vazhduar ka qenë i ligjshëm. Më 24 shtator 2012, një trup prej tre gjykatësish ka hedhur poshtë ankesën e të pandehurve ndaj atij vendimi.
11. Paraburgimi i ankuesit ishte shtyrë prapë nga 2 tetori 2012 deri më 2 dhjetor 2012. Gjykata ka gjetur se ka pasur dyshim të arsyeshëm se ankuesi mund të ketë kryer veprat penale me të cilat ishte ngarkuar dhe se ka pasur rrezik real dhe thelbësor që ankuesi mund ta kryente krimin prapë.

12. Më pas, paraburgimi i ankuesit edhe më tej ishte shtyrë deri në një datë të pasaktësuar.
13. Më 20 shkurt 2013, Gjykata e Qarkut ka urdhëruar që ankuesi të lirohet nga paraburgimi me kaucion dhe ai menjëherë ishte liruar në përputhje me atë urdhër.
14. Më 23 maj 2013, një trup gjykatësish prej tre gjyqtarësh të Gjykatës Themelore në Pejë ka dënuar ankuesin në dy pika për keqpërdorim të pozitës së tij zyrtare dhe posedim jo ligjor të një arme. Ai ka marrë një dënim prej pesë vjet burgim dhe ishte dënuar me dhjetëmijë euro. Për më tej ai ishte penguar që të mbante ndonjë pozitë publike në një periudhë prej tre vitesh pas lirimit të tij. Ankuesi menjëherë ishte ri-arrestuar. Ankuesi nuk ka parashtruar ndonjë ankesë ndaj dënimit të tij.
15. Më 23 maj 2013, Gjykata e Qarkut në Pejë po ashtu ka urdhëruar që ankuesi të mbetet në paraburgim deri sa të jepej vendimi përfundimtar lidhur me rastin.
16. Ankuesi tani është i burgosur në burgun e qarkut në Prizren.

III. ANKESAT

17. Ankuesi supozon se e drejta e tij për liri dhe siguri e garantuar me nenin 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Konventa) ishte shkelur, pasi që ai në mënyrë jo të ligjshme ishte paraburgosur; ai supozon se arrestimi dhe paraburgimi i tij ishin të motivuara politikisht. Më tej ai pretendon se paraburgimi i tij, ku ekziston një ankesë në pritje kundër vendimit të shkallës së parë, është po ashtu i jashtë ligjshëm. Ai pohon se ishte dashur që të lirohej me kaucion ashtu siç pretendon ai se urdhri i datës 20 shkurt 2013 (shih paragrafin 13 më lartë) është ende në fuqi. Ankuesi po ashtu thirret në nenin 2 të Konventës dhe pretendon se ka pasur përpjekje për ta helmuar atë përderisa ishte në paraburgim.

IV. LIGJI

18. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
19. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

Ligjshmëria e paraburgimit të ankuesit

20. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e prokurorëve të EULEX-it të marra në kontekst të hetimit penal janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë, prandaj hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit (shih p.sh. *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013, paragrafi 32; *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012, në paragrafin 21).
21. Për më tepër, veprimet dhe mos veprimet nga ana e prokurorëve të EULEX-it gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk konsiderohen, në parim, si pjesë përbërëse e “procedurës gjyqësore” për të përcaktuar kompetencat e Panelit (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, paragrafi 64). Në lidhje me këtë, Paneli ka konstatuar se “veprimet dhe mos veprimet e prokurorëve të EULEX-it [...] para ngritjes së aktakuzës mund të hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it” (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, paragrafi 93).
22. Për më tepër, nuk mund të përjashtohet se Paneli mund të jetë kompetent për të vlerësuar veprimet e prokurorëve të EULEX-it në hetimet penale edhe nëse ato i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Paneli do të jetë kompetent për të shqyrtuar aktet dhe vendimet e tilla, për shembull aty ku lënda e akteve dhe vendimeve që i nënshtrohen këtij shqyrtimi prek çështjet e të drejtave të njeriut siç është për shembull të drejtën për liri dhe siguri personale brenda kuptimit të nenit 5 të KEDNj-së. Paneli do të ndërhyjë vetëm nëse dhe aty ku akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut që i ngarkohen prokurorit nuk janë adresuar plotësisht nga autoritetet gjyqësore kompetente (shih *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013 par. 34).
23. Sa i përket çështjes në fjalë, Paneli vëren se ankuesi i kundërshton vendimet e dhëna nga gjykatat në lidhje me paraburgimin e tij dhe pajtueshmërinë e këtyre vendimeve me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut, në veçanti me të drejtën për liri personale dhe siguri të garantuar me nenin 5 të Konventës.
24. Paneli konstaton se të gjitha vendimet lidhur me paraburgimin e ankuesit ishin dhënë nga autoritetet gjyqësore kompetente me kërkesë të prokurorit. Gjykatave ju ishte dhënë një mundësi për të shqyrtuar plotësisht argumentet e prokurorit për paraburgimin e ankuesit. Për më tepër, të paktën në një rast, vendimi ishte ankimuar nga ankuesi dhe ankesa e tij ishte shqyrtuar nga një trup prej tre gjykatësish, të cilët e kanë hedhur poshtë atë ankesë. Ankuesi nuk ka identifikuar ndonjë çështje të të drejtave të njeriut që ai nuk ishte në gjendje ta ngritë në gjykatë apo se gjykata nuk kishte arritur ta adresonte atë siç duhej (shih *Z kundër EULEX-it*, cituar më lart, par. 34).
25. Paneli ka konstatuar në shumë raste, sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së vet të Punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies në

OPLAN të EULEX-it në Kosovë, se nuk ka juridiksion lidhur me aspektet administrative apo gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupi gjykues nuk nënkupton se ja humb atyre gjykatave karakterin e tyre e të qenuarit pjesë e gjyqësorit të Kosovës (shih, *ndër të tjera, Halili kundër EULEX-it*, 2012-08, 15 janar 2013, paragrafi 21; *Pajaziti kundër EULEX-it*, 2012 -05, 4 tetor 2012, paragrafët 9-10; *Dobruna kundër EULEX-it*, 2012-03, 4 tetor 2012; paragrafi 12; *Zeka kundër EULEX-it*, 2012-02, 4 tetor 2012, paragrafi 21).

26. Rrjedhimisht marrë parasysh faktin se paraburgimi i ankuesit ishte shqiptuar nga gjykata dhe se ligjshmëria e tij ishte shqyrtuar më pas në apel, Paneli nuk ka juridiksion për të shqyrtuar ankesat që kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën Gjykata e Qarkut në Pejë ka shqyrtuar ligjshmërinë e tij.
27. Prandaj ky aspekt i ankesës nuk do të shqyrtohet nga Paneli, siç është formuluar në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

Ankesat sipas nenin 2 të Konventës

28. Pretendimi i ankuesit se ka pasur tentime për ta vrarë atë derisa ishte në paraburgim janë të pabazuara. Panelit nuk ju është siguruar asnjë informacion që do ta mbështeste këtë pretendim. Po ashtu nuk ka ndonjë tregues se ankuesi ndonjëherë ishte ankuar apo se ka kërkuar nga autoritetet e Kosovës ose nga EULEX-i që të hetojnë këtë çështje.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,

gjen se kjo ankesë bie jashtë juridiksionit të Panelit sipas kuptimit të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese